



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për bonuese të zonimit

Dt. 02.07.2026

Gjakovë

Në mbështetje të dispozitave ligjore të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor, Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative, në bazë të Udhëzimit Administrativ MMPH - Nr.24/2015 Mbi Elementet, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Komunës, si dhe nenit 6 të Rregullores për Bonuset e Zonimit Nr.01-011/10-222625 dt.05.05.2025, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për bonuset e zonimit thërret këtë:

TAKIM PUBLIK

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për bonuese të zonimit, organizon takim publik të hapur me qytetarë të interesuar për trajtimin e kërkesës së **“ URBAN GROUP 112” SH.P.K. dhe “Egzoni -2” SH.P.K.** të parashtruar për bonuse të zonimit në lokacionin si vijon:

- Zona jugore e Komunës së Gjakovës - zona përgjatë rrugës “Migjeni” në parcela kadastrale me numër : **P-70705028-05895-1 Z.K. Gjakovë** jashtë qytet, nga aplikuesi **“URBAN GROUP 112” SH.P.K. dhe “Egzoni -2” SH.P.K.** për ngritjen e Kompleksit të Banimit kolektiv dhe Afarizëm.


Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për bonuse të zonimit, përmes kësaj shkrese informuese, informon banorët e zonës në mes të rrugëve “Migjeni dhe Latif Jaka” e po ashtu dhe palët e interesit lidhur me procedurën e shqyrtimit të kërkesës për bonuese të zonimit të parashtruar nga **“ URBAN GROUP 112” SH.P.K. dhe “Egzoni -2” SH.P.K.** me qëllim të realizimit të Interesit Publik.

Qëllimi i këtij takimi është informimi i banorëve të zonës dhe palët e interesit lidhur me dhënien e bonuseve të zonimit me qëllim të realizimit të interesit publik, në lokacionin që përfshihet në: **Zona jugore e Komunës së Gjakovës, përkatësisht zona përgjatë rrugëve “Migjeni dhe Latif Jaka”, parcela kadastrale me numër: P-70705028-05895-1 Z.K. Gjakovë-J-Qytet.**

Në këtë lokacion bazuar në dokumentin e planifikimit në fuqi është paraparë interesi publik, përkatësisht zgjerimi i rrugëve ekzistuese, e cila do të i shërbej interesit publik përkatësisht banorëve të zonës dhe në përgjithësi qytetarëve të Komunës së Gjakovës.

K.K.GJAKOVE
Gjakovë ZK Gjakovë Jashhtë Qytet
Parcela: 70705028-05895-1 dhe 05895-2

PLAN SITUACIONI



- Parcela me numer
- Lokacioni i objektit
- Traseja e Rrugës
- Vije e Rregullimit
- Vije e Ndërtimit
- Gjendja Faktike (objektet ekzistues)
- Gjendja Kadastrale

Lokacioni për ndërtimin e objektit të kategorisë II-III me karakter objekt banimi kolektiv me afatizëm, me etazhët B+P+7 në B+P+10 (sipas mëqësorës për bonuse të zonimit) në parcelën kadastrale ndërtimore me nr. P-70705028-05895-1 dhe 05895-2, K.Gjakovë Jashhtë Qytet, sipas Hartës Zonale Komunaie i vendosur në kartësinë për kushte të ndërtimit me nr. 07-351/02-17885 të dt. 03.06.2026

Jeton Dediadaku Inzh. dipl. ark.
Zyrtar i Lartë për Lepje të Hekërimet

Projekti i propozuar parashikon zhvillimin e një kompleksi të banimit me elemente të integruara afariste në katin përdhese, duke synuar krijimin e një strukture urbane të organizuar dhe funksionale, në përputhje me karakterin dhe potencialin e zonës, i cili është bazuar në trajtimin e parcelës si një njësi e vetme zhvillimi, duke mundësuar një organizim të qartë të volumit ndërtimor, qarkullimit dhe hapësirave të jashtme, ku në shërbim të interesit publik Investitori do të përfitojë Bonuse të Zoonimit në kuadër të projektit të prezantuar për Leje ndërtimore, në lokacionin e dhënë, të lëshuar nga DUMM, ku parashihet ndërtimi i objektit të banimit kolektiv sipas destinimit të përcaktuar me dokumentin e planifikimit hapësinor Hartës Zonale të Komunës së Gjakovës 2024-2032, **ku përkitazi nga bonuset të cilat parashihet të jepen me qëllim të realizimit të interesit publik për hapjen e rrugës për interesat e banorëve të kësaj zone, parcela me nr. P-70705028-05895-2, me S= 218.0m², e destinuar për Bonus, do të kaloj pronësi të Komunës së Gjakovës dhe do të ketë destinim hapjen e rrugës për interes të banorëve të kësaj zone.**

Takimi dëgjimor me qytetarët e interesuar do të mbahet datën 09.07.2026 në orën 10⁰⁰ në sallën e Kuvendit të Komunës së Gjakovës.

Errok Gjergjaj

